



DEMOCRACYPLUS

KOMUNA TË VOGLA, PROBLEME TË MËDHA NË PROKURIM

Komuna: Graçanicë, Mamushë,
Shtërpcë dhe Novobërdë



KOMUNA TË VOGLA, PROBLEME TË MËDHA NË PROKURIM

Komuna: Graçanicë, Mamushë,
Shtërpcë dhe Novobërdë

E drejta e autorit © 2020. Demokraci Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetei elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+.

Ky grant është mundësuar nga "Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën", financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Përmbajtja

Lista e Shkurtesave	6
Përmbledhje.....	7
Metodologjia	8
Hyrje.....	9
Komuna e Graçanicës	10
Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit ekzistues në Komunën e Graçanicës.....	11
Rehabilitimi i shtretërve të lumenjve, mureve mbrojtëse, urave dhe rrugëve lokale ne Komunën e Graçanicës	12
Furnizimi me material ndërtimorë për nevojat e Komunës së Graçanicës	14
Shërbimet e sigurimit fizik për shtëpinë e pleqve dhe shtëpinë e rinisë.....	16
Komuna e Mamushës	17
Ndërtimi i sheshit në Komunën e Mamushës - Faza e parë.....	18
Ndërtimi i kanalizimit atmosferik dhe ndërtimi i rrugëve fushore në Mamushë	19
Furnizimi me materiale për përgatitjen e festivalit të XI të domates	20
Renovimi i QMF-së në Mamushë	22
Komuna e Shtërpcës.....	23
Mirëmbajtja e rrugëve lokale gjatë sezonit të dimrit në territorin e Komunës së Shtërpcës	24
Furnizim dhe prerja e drunjve për ngrohje në shkolla dhe furnizim me pelet për ngrohje në ndërtesën e komunës	25
Transmetimi integral i seancave të Kuvendit të Komunës së Shtërpcës dhe publikimet, njoftimet dhe konkurset e ndryshme në TV.....	26
Sanimi dhe rregullimi i infrastrukturës së ekzistuese në komunën e Shtërpcë	26
Komuna e Novobërdës.....	29
Sanimi i rrugëve në Komunën e Novobërdës –Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore.....	30
Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në Komunën e Novobërdës 2019-2020.....	31
Furnizim me material ndërtimor	32
Gëlqerosja e shkollave dhe ambulancave në Komunën e Novobërdës	33
Rekomandime	34

Lista e Shkurtesave

- ATK** → Administrata Tatimore e Kosovës
- OSHP** → Organi Shqyrtues i Prokurimit
- RrUOPP** → Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik
- KRPP** → Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
- OE** → Operatori Ekonomik
- AK** → Autoriteti Kontraktues
- LPP** → Ligji për Prokurim Publik
- KV** → Kushtet e Veçanta
- ISO** → Organizata Ndërkombëtarë për Standarde
- KPM** → Komisioni i Pavarur për Media

Përmbledhje

Ky raport i monitorimit të aktiviteteve të prokurimit përfshin 16 tenderë në katër komuna, atë të Graçanicës, Mamushës, Shtërpcës dhe Novobërdës. Për secilën komunë janë monitoruar nga katër tenderë, duke filluar nga inicimi i aktivitetit të prokurimit e deri në zbatim të kontratës.

Nga ky monitorim, D+ ka identifikuar një numër gjetjesh të cilat janë të përbashkëta për këto katër komuna, por gjithashtu janë evidentuar edhe shkelje të cilat janë karakteristike e komunave specifike. Disa prej gjetjeve kryesore të këtij raporti janë:

- Në dosje të tenderit kërkohet që para nënshkrimit të kontratës fituesi ta dorëzojë vërtetimin nga gjykata se pronari, drejtori ose menaxheri i saj nuk janë dënuar gjatë dhjetë viteve të fundit për ndonjë vepër penale dhe se fituesi i kontratës nuk ka qenë i falimentuar apo insolvent. Për të katër komunat kjo kërkesë konsiderohet e plotësuar edhe nëse fituesi paraqet vërtetim për vetëm njërin nga këto elemente.
- **Komuna e Graçanicës** ka nënshkruar kontratë me vlerë rreth tre milion euro, mirëpo ky tender nuk gjendet në planin e prokurimit për vitin 2019, ndërsa buxheti i planifikuar sipas Ligjit për Buxhetin e vitit 2020 është vetëm 300 mijë euro për tri vite (2020, 2021, 2022). Në po të njëjtin aktivitet, komuna ka bërë gabime të shumta, duke mos llogaritur si duhet sigurinë e tenderit dhe atë të ekzekutimit të kontratës.
- **Komuna e Mamushës** nuk ka kërkuar që kompania e cila është tërhequr para nënshkrimit të kontratës të diskualifikohet nga pjesëmarrja në tenderë në të ardhmen. Kur tërhiqet fituesi i kontratës dyshimi është gjithmonë që fituesi me kompaninë e cila është renditur e dyta janë marrë vesh për ta kurdisur fituesin e tenderit për një çmim më të lartë. Komuna në një aktivitet tjetër ka kërkuar certifikata ISO që nuk kishin të bëjnë fare me natyrën e projektit, ndaj si rezultat i kësaj ka ofertuar vetëm një kompani, e cila i kishte të gjitha certifikatat.
- **Komuna e Shtërpcës** ka shpërblyer me kontratë kompaninë Linda SH.P.K., pronari i së cilës është dënuar për vepër penale, teksa rasti i tij ka qenë i raportuar në medie dhe përmendet në një vendim të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Me këtë veprim komuna ka shpërblyer me kontratë një kompani, e cila sipas Ligjit të Prokurimit Publik nuk ka pasur të drejtë të marrë pjesë fare në tender.
- Në dy tenderë **Komuna e Novobërdës** ka rekomanduar për kontratë kompani që kanë ofruar çmime abuzuese dhe jonormalisht të ulëta. Përdorimi i procedurës me poentim mund të shkaktojë pasiguri te ofertuesit pasi nuk mund t'i dinë paraprakisht sasinë që do të porositen, ndërsa rreziku është që një operator ekonomik (OE) të ketë informata për sasinë që do të porositen dhe të japë çmime shumë të larta në ato që porositen më shumë dhe më të ulëta në ato që porositen më pak.

Metodologjia

Në këtë raport janë monitoruar nga katër tenderë për komunat si në vijim: Graçanicë, Shtërpçë, Novobërdë dhe Mamushë. Ky raport është pjesa e parë e monitorimit të 32 tenderëve për këto katër komuna, ndërsa raporti i dytë do të publikohet në fund të vitit 2020. Tenderët e përzgjedhur janë të vitit 2018 dhe 2019. Meqenëse këto janë komuna relativisht të vogla, shpesh herë kanë qenë jashtë fokusit të organizatave joqeveritare në aspektin e monitorimit të aktiviteteve të prokurimit.

Para përzgjedhjes së tenderëve është bërë një analizë e shkurtër e së paku 10 tenderëve për secilën komunë duke analizuar rrezikun në fusha të caktuara, siç janë tenderët për sigurim fizik, ndërtim dhe mirëmbajtje të rrugëve, servisim të automjeteve, instalim dhe mirëmbajtje të ndriçimit publik. Elemente të tjera që janë marrë për bazë janë çmimet e kontratave të kaluara të të njëjtit autoritet kontraktues si dhe kontratat e autoriteteve të tjera kontraktuese. Gjatë përzgjedhjes së tenderëve rol të madh ka luajtur eksperiencia katërvjeçare e D+në monitorimin dhe analizimin e aktiviteteve të prokurimit. Në fund, duke marrë parasysh të gjitha këto elemente përzgjedhja është shkurtuar në katër tenderë për secilën komunë.

Pas përzgjedhjes së tenderëve, dokumentet, të cilat komunat janë të obliguara t'i publikojnë janë marrë nga platforma e-Prokurimi. Këtu përfshihen: njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie të kontratës, dosja e tenderit, vendimi i autoritetit kontraktues, lista e çmimeve dhe kontrata. Pjesa e tjetër e dokumenteve siç janë: procesverbal i hapjes, raporti për vlerësimin e tenderëve, faturat, zotimet dhe urdhërblerjet, raportet e pranimet teknik si dhe të gjitha ofertat janë kërkuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike. Të gjitha dokumentet që janë kërkuar, janë vënë në dispozicion të D+ nga komunat respektive. Në raport janë të analizuar të gjithë hapat e procesit të prokurimit duke filluar që nga iniciimi i aktivitetit të prokurimit, kriteret e dosjes së tenderit, vlerësimi i ofertave dhe përzgjedhja e fituesit.

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe për shkak se komunat kanë punuar me staf të reduktuar, D+ nuk ka mundur t'i monitorojë zbatimin e kontrateve në terren, mirëpo kjo synohet të bëhet në raportin e dytë, nëse situata me pandeminë përmirësohet.

Hyrje

Prokurimi publik në Kosovë ka përmirësime të vazhdueshme për çdo vit, sidomos tani kur platforma e e-Prokurimit gjithnjë e më shumë po avancohet dhe është bërë obligative që dorëzimi i ofertave dhe ankesave në formë elektronike. Megjithatë, në pjesët ku ende ka nevojë për faktorin njeri, vërehen çalime. Shkeljet e vazhdueshme të ligjit dhe rregulloret nga zyrtarët e prokurimit dhe ndëshkimet e pakta po shkaktojnë një situatë ku nuk po arrihet qëllimi i LPP-së, për prokurim efikas dhe ekonomizim. Kjo nënkupton që të blihet sa më shumë vlerë me sa më pak para.

Zakonisht janë vetë kompanitë që kanë ofertuar në një tender, ato të cilat i ekspozojnë shkeljet, së pari duke u ankuar te autoriteti kontraktues, e pastaj nëse nuk janë të kënaqura me vendimin, në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Mirëpo, nëse nuk raportohet ndonjë shkelje nga kompanitë ofertuese atëherë janë organizatat joqeveritare të cilat ekspozojnë shkeljet e ligjit dhe gabimet që bëhen gjatë hartimit të kriterëve të dosjes së tenderit.

Nevoja për t'i monitoruar aktivitetet e prokurimit të Komunës së Graçanicës, Mamushës, Shtërpcës dhe Novobërdës ka lindur pasi këto komuna janë monitoruar shumë pak në të kaluarën. Nga hulumtimi që D+ i ka bërë raporteve të publikuara për monitorim të aktivitetëve të prokurimit gjatë pesë viteve të fundit ka gjetur se vetëm Komuna e Mamushës ka qenë në një raport të tillë, ndërsa tri komunat tjera jo.

“Demokrasi Plus” angazhohet që përmes monitorimit të vazhdueshëm të aktivitetëve të prokurimit të nxjerr në pah shkeljet e ligjit, të ekspozojë korrupsionin potencial dhe neglizhencën e zyrtarëve të prokurimit. Në anën tjetër, gjetjet dhe rekomandimet ofrojnë pikë referimi për zyrtarët e prokurimit në mënyrë që t'i evitohen shkeljet e dispozitave ligjore në të ardhmen.



Komuna e Graçanicës

Në komunën e Graçanicës janë monitoruar katër aktivitete të prokurimit, ndër të cilat dy janë tenderë për punë, një është për shërbime si dhe një për furnizim.

Në tenderin për instalim dhe riparim të ndriçimit publik, komuna ka përdoruar procedurën e kontratës kornizë për punë, në vend që ta përdorte procedurën normale për punë. Në këtë aktivitet ka pasur një kërkesë për rishqyrtim, ndërsa komuna ka nxjerrë një vendim të mangët me të cilin e ka pezulluar tenderin dhe nuk ka publikuar fare vendimin për kërkesën për rishqyrtim në platformën e-Prokurimi.

Në një aktivitet tjetër të prokurimit janë bërë shumë gabime dhe shkelje në dosje të tenderit. Siguria e ekzekutimit të kontratës është kërkuar me afat më të gjatë se maksimumi i lejuar me ligj. Vlera e sigurisë së tenderit është kërkuar më shumë se maksimumi i lejuar me ligj. Kushtet e Veçanta nuk janë kërkuar, si dhe më e rëndësishmja, tenderi me vlerë mbi katër milionë euro nuk ka qenë fare i planifikuar.

Në tenderin për furnizim me material ndërtimor komuna e ka pranuar vërtetimin nga gjykata për fituesin e kontratës e cila nuk i plotësonte të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Fituesi ka sjellë vërtetimin i cili vërteton vetëm se kompania nuk ka qenë në falimentim apo insolvente¹, mirëpo jo a ka qenë ndonjë drejtor ose menaxher i saj i dënua për vepër penale gjatë 10 viteve të kaluara.

Komuna nuk e ka publikuar asnjërin nga këto katër kontrata në platformën e-Prokurimi, gjë të cilën është e obliguar ta bëjë.

¹ Pamundësia e një kompanie që të paguajë borxhet e saj me kohë.



Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit ekzistues në Komunën e Graçanicës

Komuna e Graçanicës tenderin për instalim të ndriçimit publik dhe riparim të atij ekzistues e kashpallë dy herë. Të parin e anuloi pasi të gjitha ofertat përmbanin çmime jonormalisht të ulëta për disa pozicione. Në tenderin e dytë morën pjesë katër kompani:

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	M.V.R. Elektromontues & Dino SH.P.K.	108,381.50
2.	N.N.T. A.B.C.	111,025.50
3.	Termomontimi SH.P.K.	148,705.00
4.	BM Group SH.P.K.	135,999.00

TABELA 1. Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit "Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit ekzistues në Komunën e Graçanicës – Ritender"

Në tenderin e dytë (apo ritenderim), fitues fillimisht u zgjodh kompania A.B.C me çmim 111,025.50 euro, M.V.R. Elektromontues & Dino SH.P.K. u shpallë i papërgjegjshëm, teksa dy kompani të tjera ishin të përgjegjshme, por me çmim më të lartë. M.V.R. Elektromontues & Dino SH.P.K. nuk i kishte dorëzuar të noterizuara tri ISO certifikata si dhe nuk kishte ofruar dëshmi për një cilindër minimum 7 ton.

Kundër këtij vendimi është ankuar konsorciumi M.V.R. Elektromontues & Dino SH.P.K., mirëpo komuna ka nxjerrë një vendim për pezullim të aktivitetit të prokurimit që është shumë i paqartë, pasi nuk përmban asnjë të dhënë rreth arsyes së pezullimit. Vendimi për pezullim duhet së paku të përmbajë emrin e operatorit ekonomik, i cili është ankuar si dhe arsyen e pezullimit të aktivitetit të prokurimit. Mirëpo, gabimi i komunës vazhdon më tej pasi vendimin për kërkesën për rishqyrtim nuk e ka publikuar në platformën e-Prokurimi, ku është e obliguar ta bëjë një gjë të tillë në bazë të Rregullave për Parashtrim të Ankesave².

Mospublikimi i vendimit të komunës nënkupton që OE të tjerë nuk kanë qenë të njoftuar me këtë vendim, çka do të paraqiste problem të madh nëse ata do të dëshironin të ankoreshin kundër këtij vendimi. Kjo ngase, OE-të nuk mund të ankohen kundër një vendimi, i cili zyrtarisht nuk ekziston, edhe pse kanë mundur të sigurojnë informata rreth tij përmes rrugëve jozyrtare.

Komuna nxori një vendim të ri për dhënie të kontratës ku fitues u zgjodh konsorciumi M.V.R. Elektromontues & Dino SH.P.K dhe me këtë nënkuptohet që kërkesa për rishqyrtim është aprovuar. Komuna i ka kërkuar sqarime konsorciumit për certifikatat ISO, të cilat kanë qenë të panoterizuara kur ky konsorcium ka aplikuar në tender ndërsa i ka sjellë të noterizuara pas kërkesës së komunës. Por, a duhet ta lejonte komuna një gjë të tillë mbetet e paqartë, derisa nuk ka ndonjë ndryshim material të ofertës dhe për shkak të çmimit më të lirë, kjo mund të cilësohet si devijim i vogël në përputhje me nenin 59.4 të Ligjit të Prokurimit Publik³. Sa i përket cilindrit minimum 7 ton, ky ka qenë një gabim i komunës pasi kjo pajisje ka qenë në listën e pajisjeve të anëtarit të konsorciumit, Dino SH.P.K..

2 F03 Rregullat për parashtrim të ankesave-Verzioni 2. KRPP. 2016
<https://bit.ly/3gJq4fw>

3 Ligji nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2011.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

Ky aktivitet i prokurimit në Planin e Prokurimit për vitin 2019, e ka vlerën e parashikuar prej 100,000 euro, mirëpo komuna tenderin e ka shpallur me vlerë të parashikuar prej 200,000 euro. Kjo vlerë është për 100% më e lartë se vlera në planin e prokurimit. Po të analizohen ofertat në tenderin e parë, oferta më e ulët ishte rreth 94,000 euro, ndërsa në tenderin e dytë rreth 110,000 euro. Kjo mund të jetë një sinjal se komuna nuk e ka planifikuar si duhet vlerën e parashikuar.

Procedura e përdorur për këtë tender, është kontratë kornizë për punë për një periudhë 36 mujore. Kontrata kornizë për punë mund të përdoren vetëm për riparime dhe mirëmbajtje⁴ dhe jo për kategori të tjera të punëve. Ky tender ka vetëm një përqindje të vogël ku parashihen riparime dhe pjesa më e madhe ka të bëjë me instalime. Në tenderët për punë zakonisht dihet sasia e punëve që do të realizohen, përderisa kontrata kornizë mundëson që porositë të bëhen kur lindë nevoja dhe kur ato bëhen kërkesa të vazhdueshme, p.sh., një tender për furnizim me ujë është kërkesë e vazhdueshme, pasi që është produkt që konsumohet dhe në momentin që mbaron stoku, porositet prapë. Përderisa instalimi i ndriçimit publik dhe të gjitha punëve përgatitore që bëhen, kryhet vetëm një herë dhe nuk ka nevojë që të ketë porosi të reja.

Në dosjen e tenderit kriteri i paqartë dhe i paspecifikuar si duhet është kërkesa për dy autokorpa me lartësi të ndryshme. Autokorpa shërben për të ngritur lartë punëtorët, të cilët sa i përket këtij tenderi do të montonin llampat në trupat ndriçues. Nëse nevoja është që punëtorët të ngriten në 10 metra lartësi, mirëpo autokorpa e fituesit të kontratës mund të ngritet vetëm 8 metra, atëherë punët nuk do të mund të realizoheshin. Kjo është vetëm një situatë e supozuar se çka do të mund të ndodhte nëse kërkesat e dosjes së tenderit janë të paspecifikuara si duhet. Komuna është dashur ta shënojë edhe lartësinë e autokorpave për t'i ikur keqkuptimeve potenciale në të ardhmen.

Kushtet e Veçanta (KV) të dosjes së tenderit nuk janë kërkuar me rastin e publikimit të tenderit. Ky veprim bie ndesh me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik (RuOPP)⁵, sipas të cilit këto kushte duhet që të përgatiten së bashku me dosjen e tenderit. Mos specifikimi i tyre mund të shpie në situatë ku disa operatorë ekonomik të jenë në avantazh nëse i dinë kushtet paraprakisht. Në këto kushte specifikohet garancioni për produktet, i cili ndikon në çmimin që do ta ofrojë operatori ekonomik. Elemente të tjera që specifikohen në KV janë afati për të filluar punimet, menaxheri i kontratës si dhe më e rëndësishmja cili organ është përgjegjës në rast se ka mosmarrëveshje.

Rehabilitimi i shtretërve të lumenjve, mureve mbrojtëse, urave dhe rrugëve lokale ne Komunën e Graçanicës

Në këtë aktivitet të prokurimit Komuna e Graçanicës ka bërë bashkë disa aktivitete, të cilat zakonisht prokurohen të ndara nga autoritete të tjera kontraktuese. Kjo nuk do të thotë që ka bërë gabim, mirëpo me qëllim të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme komuna ka mundur që tenderin ta ndajë në lote. Vlera e parashikuar e këtij tenderi është 4,278,000 euro, mirëpo në planin e prokurimit të vitit 2019 ky aktivitet nuk gjendet. Çdo aktivitet i prokurimit duhet të planifikohet dhe të jetë në planin e prokurimit, mirëpo kur një vlerë kaq e lartë shpenzohet pa u planifikuar, atëherë kjo cilësohet shkelje e rëndë. Në Buxhetin e vitit 2020, është vetëm një investim kapital i përafërt me titull "Rregullimi i shtratit të lumenjve", ku vlera e paraparë për tri vite (2020-2022) është 300,000 euro⁶, pra dukshëm më e ulët se vlera e parashikuar e këtij tenderi.

Fitues i kontratës u përzgjedh kompania N.N.T A.B.C & Europa Partners SH.P.K. me çmim 2,996,324 euro e cila kishte edhe çmimin më të ulët, ndërsa të gjithë ofertuesit tjerë janë cilësuar si të përgjegjshëm.

4 Neni 56.2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. KRPP. 2019
[https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01 2019/Rregullat dhe Udhëzuesi 10 04 2019 2.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udhëzuesi%2010%2004%202019%202.pdf)

5 Neni 18.3. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. KRPP. 2019
[https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01 2019/Rregullat dhe Udhëzuesi 10 04 2019 2.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udhëzuesi%2010%2004%202019%202.pdf)

6 Ligji Nr. 07L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020
<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	N.N.T. A.B.C. & Europa Partners SH.P.K.	2,996,324.00
2.	Dino SH.P.K.. & Victoria Invest International SH.P.K.	3,981,079.00
3.	Saba Belca & Graniti Com & SB Concstruction	3,493,265.00
4.	Alko Impex & 2T SH.P.K.	4,104,897.50
5.	Beni-Com SH.P.K.	3,864,609.00

TABELA 2. Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit "Rehabilitimi i shtretërve të lumenjve, mureve mbrojtëse, urave dhe rrugëve lokale ne Komunën e Graçanicës"

Në dosje të tenderit janë disa shkelje që i ka bërë komuna:

- Edhe në këtë aktivitet të prokurimit nuk janë kërkuar Kushtet e Veçanta. Përveç që KV-të duhet të kërkohej sipas RrUOPP-së, shpjegimet se çka ndodh nëse nuk kërkohej mund t'i lexoni më lartë.
- Siguria e Ekzekutimit është kërkuar për 48 muaj, ndërsa është dashur të kërkohej për 37 muaj, pasi afati për përfundimin e kontratës është 36 muaj. Sipas RrUOPP-së:
"30.6 Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës."
 Në këtë rast siguria e ekzekutimit të kontratës është kërkuar për 11 muaj më shumë, gjë e cila shkakton kosto te operatori ekonomik që ka fituar kontratën, pasi polica e sigurimit do të kushtojë më shumë.
- Vlera e kërkuar e sigurimit të tenderit ka tejkaluar limitin ligjor. Në dosje, sigurimi i tenderit është kërkuar që të jetë 130,000 euro, mirëpo në bazë të RrUOPP⁸-së, kjo shumë duhet të jetë në mes 1 deri në 3% të vlerës së parashikuar të tenderit:

VLERA E PARASHIKUAR 4,278,000 EURO * 0.03 (MAKSIMUMI 3%) = 128,340 EURO

7 Neni 30.6. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. KRPP. 2019
[https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01 2019/Rregullat dhe Udhëzuesi 10 04 2019 2.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udhëzuesi%2010%2004%202019%202.pdf)

8 Neni 29.4. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. KRPP. 2019
[https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01 2019/Rregullat dhe Udhëzuesi 10 04 2019 2.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udhëzuesi%2010%2004%202019%202.pdf)

Për sigurinë e tenderit duhet të paguhet policë sigurimi dhe pasi vlera e kërkuar është më e lartë se ajo që është parashikuar sipas ligjit janë shkaktuar shpenzime shtesë për të pesë kompanitë që kanë marrë pjesë në këtë tender.

- Edhe në këtë tender është përdorur procedura e kontratës kornizë për punë për një periudhë 36 mujore. Siç është cekur më lartë kontrata kornizë për punë mund të përdoret vetëm për riparime dhe mirëmbajtje dhe jo për kategori të tjera të punëve. Edhe në këtë tender ka përzjerje të punëve ku disa janë riparime dhe mirëmbajtje dhe disa janë punë të reja.
- Është kërkuar që për lista të kontratave të përfunduara në lëminë e kërkuar ose të ngjashme për periudhën e shkuar tre vjeçare të jetë jo më pak se 4,000,000 euro. Operatori ekonomik duhet të ketë në kuadër të këtyre referencave së paku një referencë në vlerë prej 2,000,000 euro për asfaltimin e rrugëve lokale. Kjo kërkesë bie ndesh me LPP⁹-në, i cili kërkon që kërkesa për referenca të mos bëhet me numër të kontratave, por me vlerën totale të kontratave. Sipas këtij përkufizimi komuna është dashur që të kërkojë referenca që kur të mblidhet shuma e tyre të jetë dy milion euro e jo që vetëm një referencë ta ketë këtë vlerë. Kjo kërkesë e kufizon konkurrencën në masë të madhe.

Të gjitha këto gabime dhe shkelje nuk do të duhej të ndodhnin pasi janë elementet më bazik të një dosje të tenderit. Në tenderët e ardhshëm komuna duhet të sigurohet t'i evitohet gabimet në llogaritje të sigurisë së tenderit dhe ekzekutimit.



Furnizimi me material ndërtimorë për nevojat e Komunës së Graçanicës

Vlera e parashikuar e tenderit për furnizim me material ndërtimorë ishte 350,000 euro, mirëpo edhe ky tender nuk ishte në planifikimin e prokurimit për vitin 2019. Fitues i kontratës u zgjodh kompania N.N.T. A.B.C. me çmim 256,010 euro, i cili njëkohësisht ishte çmimi më i ulët prej të gjitha ofertave.

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	BAU MARKET SH.P.K	313,749.00
2.	Gama Ing SH.P.K	285,000.00
3.	N.N.T. A.B.C.	256,010.00
4.	Kujtim Gërbeshi	299,385.00
5.	HIDRO PROJECT SH.P.K. & HIDRO BAU " SH.P.K	274,890.00
6.	Beni Construction SH.P.K.	315,990.00
7.	RAD D.O.O.	295,002.60
8.	Grand Bau SH.P.K. & ENGRUP SH.P.K.	287,430.00

TABELA 3. Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me material ndërtimorë për nevojat e Komunës së Graçanicës"

⁹ Ligji nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2011. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

Katër ofertues u eliminuan pasi nuk plotësonin kriterin që të kenë referenca të ngjashme për furnizim me material ndërtimor në vlerë prej 350,000 euro. Kompania Gama Ing u ankuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit për këtë çështje, i cili i dha të drejtë pjesërisht¹⁰. OSHP referencat e paraqitura nga Gama Ing i cilësoi që e përmbushin kërkesën, mirëpo ankesën ndaj N.N.T. A.B.C. në lidhje me referencat e saj nuk e aprovoi. Fituesi i kontratës kishte paraqitur tri referenca të lidhura me kompaninë RAD (e cila ishte pjesëmarrëse në këtë tender) të cilat ishin të dëshmuara me kontratë, referencë nga RAD si dhe dëshminë e pagesës përmes bankës.

Në dosje të tenderit krahasuar me tenderin për rehabilitimin e shtretërve të lumenjve, mureve mbrojtëse, trotuareve dhe rrugëve lokale ka më pak gabime. Sigurimi i tenderit dhe i ekzekutimit të kontratës janë kërkuar sipas ligjit. Mirëpo, gabimet e zakonshme janë se KV-të nuk janë kërkuar në dosje të tenderit në kohën kur është publikuar njoftimi për kontratë, përgjigja në kërkesën për rishqyrtim të bërë nga "Gama Ing" nuk është publikuar në platformën e-Prokurimi në mënyrë që të njoftohen të gjithë operatorët tjerë ekonomik me vendimin e komunës.

Në çdo dosje të tenderit është kërkesa që operatorët ekonomik që shpërblehen me kontratë duhet t'i përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë me vërtetim të gjykatës. Këto kërkesa janë ndarë në tri kategori të cilat gjenden në çdo dosje të tenderit. Në kërkesat e kategorisë -së parë OE-të duhet të dëshmojë se nuk ka ndihmuar në hartimin e dosjes së tenderit dhe se nuk ka konflikt interesi. Në kategorinë e dytë kërkohet që OE-të, të dëshmojë se ndonjë drejtor ose menaxher nuk është shpallur fajtor nga gjykata. Përmes kërkesave në kategorinë e tretë kërkohet të dëshmohet se kompania nuk është në falimentim ose insolvente. Kërkesa në dosje të tenderit është:

Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë" – të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.

OE i cili ka fituar kontratën, N.N.T. A.B.C. ka sjellë vërtetimin nga gjykata që thotë se kompania nuk ka qenë e falimentuar ose insolvente gjatë dy viteve të kaluara dhe ndaj të njëjtës nuk është iniciuar procedura e falimentimit, përkatësisht e likuidimit.

Nuk është - shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy viteve të kaluara, dhe ndaj të njëjtit
Nije proglašen pod stečaj ili nelikvidan u protekle dve godine, i protiv istog

nuk është - e iniciuar procedura e falimentimit përkatësisht e likuidimit
nije – pokrenut postupak stečaja odnosno raspuštanja /likvidacije/.

FIGURA 1. Pjesë nga vërtetimi i gjykatës për N.N.T. A.B.C.

Ky vërtetim nuk e mbulon në tërësi kërkesën e komunës, pra vërtetimi nuk tregon se a e ka pasur kompania ndonjë drejtor ose menaxher të dënuar në 10 vitet e fundit për ndonjë vepër penale. Komuna nuk është dashur ta pranojë këtë vërtetim si të tillë, por është dashur të kërkojë nga kompania vërtetimin që mbulon të gjitha kërkesat e përshtatshmërisë.

¹⁰ Vendimi 23/20. Organi Shqyrtues i Prokurimit. 2020.
<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/44c3e1a8-974d-ea11-b589-005056ba09d5>



Shërbimet e sigurimit fizik për shtëpinë e pleqve dhe shtëpinë e rinisë

Tenderët për sigurim fizik në përgjithësi po ballafaqohen me sfida pasi që autoritetet kontraktuese nuk i llogarisin në mënyrë të saktë shpenzimet e parapara nga Ligji i Punës¹¹, ndaj kompanitë ankohen në OSHP, e cila gjithashtu ka probleme me këto llogaritje¹². Në tenderin e Komunës së Graçanicës nuk ka gabime të tilla. Komuna ka llogaritur saktë sa është kufiri nën të cilën oferta është me çmim jonormalisht të ulët. Si pasojë kompania Commando është eliminuar pasi oferta e saj ka qenë nën pragun minimal për vetëm 11.75 euro. Kontratën e fitoi OE Rosa Security me çmim prej 59,909.76 euro, ndërsa ofertat tjera ishin këto:

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	Commando SH.P.K.	57,738.96
2.	Rosa Security SH.P.K.	59,909.76
3.	SFK SH.P.K.	62,069.00
4.	Besa Security	81,678.60
5.	K.S.AS - SECURITY SH.P.K.	68,694.84
6.	Luani SH.P.K.	64,797.84

TABELA .

Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e sigurimit fizik për shtëpinë e pleqve dhe shtëpia e rinisë"

Edhe ky tender i ka disa gabime që janë bërë gjatë hartimit të dosjes së tenderit. Titulli i tenderit është "Shërbimet e sigurimit fizik për shtëpinë e pleqve dhe shtëpia e rinisë", mirëpo në specifikacionin teknik thuhet se kompania do të bëjë sigurimin fizik të objektit të Kuvendit Komunal të Graçanicës. Kjo ka mundur të jetë një gabim teknik, megjithatë ka mundur të shkaktojë konfuzion tek operatorët ekonomik që kanë ofertuar, pasi sipas titullit të tenderit sigurimi fizik do të bëhet në dy lokacione të ndryshme, ndërsa në bazë të specifikave, vetëm në objektin e Kuvendit Komunal.

Dy elementet që u përsëritën edhe në tri aktivitetet tjera më lartë janë edhe në këtë tender, KV nuk janë paraqitur në dosje të tenderit, ndërsa aktiviteti ka qenë i planifikuar, mirëpo vlera në plan të prokurimit për vitin 2019 është 17,366.88 euro, ndërsa vlera e parashikuar e këtij tenderi është 70,000 euro.

11 Problemet (e shumta) në Prokurim Publik, faqe 17. Demokraci Plus. 2020.

<https://dplus.org/wp-content/uploads/2020/03/2020-03-problemet-e-shumta-ne-prokurim-publik-1.pdf>

12 Roli i Organit Shqyrtues të Prokurimit në mosefikasitet në Prokurim publik, faqe 38. Demokraci Plus. 2019.

<https://dplus.org/wp-content/uploads/2019/11/2019-06-Roli-i-OSHP-në-mosefikasitet-në-prokurim-publik.pdf>



Komuna e Mamushës

Në komunën e Mamushës janë monitoruar katër aktivitete të prokurimit, ndër të cilat, tri për kontraktim të punëve dhe një për furnizim.

Në tenderin për ndërtimin e sheshit komuna ka kufizuar konkurrencën me kërkesa për standarde ISO, të cilat nuk ishin relevante me natyrën e projektit që do të realizohej.

Në një aktivitet tjetër komuna ka kufizuar konkurrencën pasi ka kërkuar që kapaciteti teknik dhe profesional të dëshmohej përmes tri kontratave të realizuara për punë të ngjashme, mirëpo kërkesa nuk do të duhej të përcaktonte numrin e kontratave, por do duhej të kërkohej vetëm një listë e kontratave për punë të ngjashme.

Në tenderin për furnizim me materiale për përgatitjen e Festivalit të XI të Domates, OE i rekomanduar për kontratë nuk kishte dorëzuar vërtetimet nga gjykata dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), ndaj komuna ia dha kontratën ofertuesit të dytë. Mirëpo, komuna nuk ka bërë kërkesë që OE i shpallur fillimisht fitues të diskualifikohet nga tenderët e ardhshëm, ashtu siç kërkohet me rregullat e prokurimit. Në të njëjtin tender, komuna ka pranuar katalogë, të cilët janë shkruar nga vetë kompania fituese e tenderit, në mënyrë që të përputhen specifikat teknike të kërkuara.

Në tenderin për renovim të QMF-së, janë kërkuar tri referenca për punë të ngjashme të përfunduara nga OE-të, ndërsa do të duhej të kërkohej një listë e projekteve të përfunduara si dhe vlera e tyre. Në këtë mënyrë, kërkesa e komunës e ka kufizuar konkurrencën.

Veprimet pozitive të Komunës së Mamushës për dallim nga Komuna e Graçanicës janë që KV-të. Në të katër tenderët, ata janë kërkuar së bashku me dosjen e tenderit.



Ndërtimi i sheshit në Komunën e Mamushës - Faza e parë

Në tenderin për ndërtimin e sheshit në Komunën e Mamushës ofertoi vetëm një konsorcium, i cili e fitoi kontratën, NBT ING & Eko Group me çmim 199,120.71 euro, ndërsa vlera e parashikuar e tenderit ishte 202,700 euro. Çmimi i kontratës është sa 98.23% e vlerës së parashikuar.

Anëtar i konsorciumit, NBT ING i ka dorëzuar dy dokumente të cilat nuk janë në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit. AK ka kërkuar që OE të ketë të paguar taksat komunale dhe tatimin në pronë dhe këto të dëshmojnë përmes vërtetimit i cili nuk duhet të jetë më i vjetër se 60 ditë nga data e lëshimit deri në datën e dorëzimit të ofertave. Vërtetimet e lëshuara për NBT ING kanë datën 17.06.2019, ndërsa hapja e ofertave ka qenë me 02.09.2019, apo 77 ditë më vonë se data e lëshimit. Komuna është dashur që para nënshkrimit të kontratës ti kërkojë edhe njëherë këto dokumente dhe nëse do të vërtetonin që NBT ING nuk ka borxhe atëherë mund të nënshkruhej kontrata. Me këtë veprim, komuna ka shkelur kriteret që i ka vendosur vetë në dosje të tenderit.

Në paramasë në pozicionet 1.3.5 deri në 1.3.9 janë kërkuar “pllaka e gurë natyrorë për dysheme në hapësira të jashtme” me këto metoda të testimit:

EN 12407, EN 13755, EN 1926, EN 14157, EN 12731, EN 12372, **EN 13161**, EN 14066, EN 1936, EN 14231

Këto standarde janë kërkuar të dëshmojnë me certifikatën e konformitetit, të cilën konsorciumi i rekomanduar e ka në ofertën e tij. Mirëpo standardi EN 13161 nuk është i përfshirë në këtë deklaratë dhe përderisa është kriter i vendosur nga komuna dhe shprehimisht është kërkuar që të gjitha këto standarde të dëshmojnë përmes certifikatës së konformitetit atëherë kjo e bën të papërgjegjshme ofertën e NBT ING & Eko Group.

Komuna ka kërkuar pesë certifikata ISO, 9001, 14001, 27001, 50001 dhe OHSAS 18001. Nga këto, tri prej tyre 9001, 14001 dhe OHSAS 18001 janë relevante për këtë projekt, pasi përfshijnë sistemin për menaxhim të kualitetit (9001), sistemin për menaxhimin e mjedisit (14001) dhe sistemi për menaxhimin e shëndetit dhe rrezikut në punë (OHSAS 18001). Mirëpo dy të tjerat, ISO 27001 dhe 50001 nuk kanë të bëjnë fare me natyrën e projektit në fjalë. ISO 27001 ka të bëjë me menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe përdoret nga organizatat që menaxhojnë sigurinë e informacioneve financiare, pronësinë intelektuale dhe informacione që vijnë nga palët e treta¹³. Puna që pritet të realizohet në projektin e komunës nuk ka të bëjë fare më këto fusha, prandaj ka qenë e paarsyeshme të kërkohej kjo certifikatë ISO. E njëjta situatë qëndron edhe me ISO 50001, e cila mbulon menaxhimin e energjisë¹⁴. D+ ka analizuar 50 dosje të tenderit të autoriteteve të ndryshme kontraktuese për tender të ngjashëm dhe në asnjë prej tyre nuk është kërkuar ISO 27001 apo 50001. Këto dy ISO pra nuk janë relevante me natyrën e projektit dhe janë të ndaluara të kërkojnë në bazë të LPP-së.

Komuna në lidhje për kërkesat për certifikata ISO është përgjigjur se këto janë kërkuar nga kompania që ka bërë hartimin e projekteve. Në përshkrimin teknik të projektit për ndërtimin e sheshit nuk përmendet asnjë certifikatë ISO dhe në asnjë pjesë të tekstit nuk ka referenca për ISO 27001 që ka të bëjë me menaxhimin e sigurisë së informacionit apo ISO 50001 që ka të bëjë me menaxhimin e energjisë. Prandaj përgjigja që ka dhënë komuna nuk është bindëse, dhe D+ mendon që këto dy ISO certifikata nuk janë relevante me natyrën e projektit.

13 ISO/IEC 27001.
<https://www.iso.org/isoiec-27001-information-security.html>

14 ISO 50001
<https://www.iso.org/iso-50001-energy-management.html>

Gjithashtu, Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP) në një njoftim ka ngritur shqetësimin se disa autoritete kontraktuese po kërkojnë certifikata ISO që nuk kanë lidhshmëri me natyrën e projekteve¹⁵. Si rezultat i këtyre kërkesave për certifikatave ISO jorelevante, nuk kanë ofertuar shumë kompani. Zakonisht kompanitë që merren me ndërtim nuk kanë ISO 27001 dhe 50001. Pra, me këtë veprim komuna ka kufizuar konkurrencën në masë të madhe.

Veprimet pozitive të komunës janë se për punimet e gurit, OE-të duhet të ofrojnë garancion pesëvjeçar, ndërsa Kushtet e Veçanta janë specifikuar së bashku me dosjen e tenderit, për dallim nga Komuna e Graçanicës, e cila nuk i specifikonte fare.

Ndërtimi i kanalizimit atmosferik dhe ndërtimi i rrugëve fushore në Mamushë

Në tenderin për ndërtimin e kanalizimit atmosferik dhe ndërtimin e rrugëve fushore morën pjesë tetë ofertues, ndërsa fitues u zgjodh konsorciumi N.N.P. Aurex & Lani-AL SH.P.K. me çmim 43,306.50 euro. Mirëpo oferta me çmimin më të lirë ishte konsorciumi Intact SH.P.K. & Ademaj Arch-Ing me 37,622.50 euro. Ky konsorcium u eliminua pasi nuk i kishte tri referenca për punë të ngjashme. Komuna i kishte dhënë kohë që t'i dëshmojë referencat, por konsorciumi nuk kishte arritur.

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	N.N.T. Veha	50,900.00
2.	AAB Construction SH.P.K. & Mirusha Company SH.P.K.	52,332.50
3.	N.N.P. Aurex & Lani-AL SH.P.K.	43,306.50
4.	Intact SH.P.K. & Ademaj Arch-Ing	37,622.50
5.	N.P.T. Bamirs	47,997.00
6.	Hysen Sopa B.I.	48,270.00
7.	Flori SH.P.K.	44,400.00
8.	N.N.SH. World Medium	57,767.50

TABELA 5. Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i kanalizimit atmosferik dhe ndërtimi i rrugëve fushore në Mamushë”

¹⁵ Njoftimi 88/2019. KRPP. 2019.
<https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Notices/atb/398/001.jpg>

Edhe në këtë dosje të tenderit ka elemente, të cilat e kanë kufizuar konkurrencën. Ndër to është kërkesa që ofertuesi t'i prezantojë tri referenca për punë të ngjashme, ndërsa kërkesa do të duhej të ishte që ofertuesi të prezantojë referenca në një vlerë të caktuar, pra të mos kufizohet te numri i referencave, por te vlera e tyre. Konkurrenca në këtë rast dëmtohet pasi mund të ketë kompani që ka dy referenca me vlerë shumë të madhe, e cila do të eliminohej nga ky tender, por mund të ketë kompani që i ka tri referenca me vlerë shumë të vogël dhe e cila nuk do të eliminohej. Për autoritetin kontraktues më e rëndësishme duhet të jetë madhësia e projekteve që i ka realizuar një kompani se sa numri i tyre.

Komuna nuk është pajtuar me këtë gjetje dhe ka thënë se kërkesa për minimum tri referenca është e bazuar në ligj dhe kufizim i konkurrencës do të ishte nëse do të kërkohej numër i caktuar i referencave dhe njëkohësisht edhe vlera e caktuar e projekteve. Ky konstatim është i paskatë pasi neni 69 i LPP thotë që duhet të kërkohej një listë e kontratave të realizuara (që dëshmojnë përmes referencave). Për këtë çështje ka Opinione nga AKK¹⁶ dhe OSHP¹⁷ të cilat thonë se me rëndësi është të përmbushet vlera e caktuar (nëse është kërkuar) dhe jo të kufizohet përmbushja e kërkeses me numër të referencave. Për ta shpjeguar më qartë kërkesa në dosje të tenderit do të duhej të ishte:

"Një listë të kontratave që dëshmon se OE ka përfunduar me sukses kontrata për punë të ngjashme në vlerën XXX në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë"

Një kërkesë të tillë si më lartë komuna e ka bërë në tenderin për ndërtim e sheshit, prandaj arsyetimi i komunës se kërkesa është në pajtim me ligjin nuk qëndron. Përderisa në tenderin për ndërtim të sheshit nuk e ka kufizuar numrin e referencave, por ka caktuar vetëm vlerën, pse mos ta bënte një gjë të tillë edhe në tenderin për ndërtim të kanalizimit atmosferik.

Komuna e Mamushës duhet që kërkesat për referenca t'i formulojë në atë mënyrë që të kërkohej referenca pa specifikuar numrin e tyre, por duke specifikuar vlerën e tyre ose nëse e shih të arsyeshme të mos e specifikojë vlerën fare.



Furnizimi me materiale për përgatitjen e festivalit të XI të domates

Tenderin për furnizim me materiale për përgatitjen e festivalit të XI të domates ishte ndarë në dy lloje, ndërsa fillimisht për lot 2 fitues u zgjodh kompania Agrovina me çmim 48,811 euro. Mirëpo kjo kompani ka dështuar të sjellë dokumentet që kërkohej para nënshkrimit të kontratës: vërtetimi nga gjykata, me të cilin dëshmohet se kompania i ka plotësuar kërkesat e përshtatshme, vërtetimin që nuk ka borxhe ndaj ATK-së, vërtetimin që i ka paguar taksat komunale në vendin ku është regjistruar dhe vërtetimin për pagesë të tatimit në pronë. Komuna i ka dhënë afat pesë ditë kompanisë që t'i sjellë këto dokumente dhe pasi kompania ka dështuar, komuna i ka dhënë kontratën ofertuesit të dytë, Haxhijaha 51,630 euro. Haxhijaha fitoi gjithashtu kontratën për lot 1 me çmim 2,249 euro.

Sipas RrUOPP¹⁸, nëse një ofertues është zgjedhur fitues, mirëpo dështon t'i dorëzojë certifikatat e kërkuara, atëherë vazhdohet me ofertuesin e dytë, mirëpo autoriteti kontraktues (AK) duhet që të konfiskojë sigurinë e tenderit si dhe të iniciojë procedurën për diskualifikimin e OE sipas nenit 99.2 të LPP.

16 Agjencia Kunder Korrupsion. Opinioni 2366/19. 2019.
https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Opinionet/2019/2366-19_opinion_dpkpp_K.Gjitanit.pdf

17 Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 404/19. 2019.
<http://arkivaoshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/404-19vendim.pdf>

18 Neni 26.8, faqe 65. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. KRPP. 2019
https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01_2019/Rregullat_dhe_Udhezusi_10_04_2019_2.pdf

Diskualifikimi mund të zgjasë deri në një vit, gjatë të cilës kohë OE nuk ka të drejtë të marrë pjesë në tenderë. Këtë vendim e merr OSHP, pas kërkesës që paraqitet nga AK. Në këtë tender nuk është kërkuar siguria e tenderit, por AK si duket nuk ka bërë kërkesë në OSHP që kompania Agrovin të diskualifikohet. Ekziston gjithmonë rreziku për marrëveshje të fshehta kur kompanitë që zgjidhen fituese tërhiqen ose nuk dorëzojnë dokumentet e kërkuara para nënshkrimit të kontratës.

Në dosje të tenderit për llotin 2 janë kërkuar tri pajisje, ndër to një traktor pa kabinë. Nga përshkrimi i specifikave teknike për traktor ato duken që të jenë përshtatur për modelin Tafe 42 DI¹⁹ pasi specifikat e këtij traktori janë të njëjta me ato që janë kërkuar në dosje të tenderit. LPP e ndalon që specifikat teknike të përshtaten për një markë të caktuar, përveç në raste të caktuara kur nuk është e mundur, mirëpo duhet që të shtohet fjala “e barasvlefshme” ose “ekuivalente”, e që në këtë rast është shtuar fjala e barasvlefshme, me çka komuna ka respektuar ligjin²⁰.

Për produktet në llotin 2 është kërkuar që ato të dëshmohen përmes katalogjeve, broshurave apo fotografive. Specifikat e produktit që janë në katalog ose broshurë duhet të përshtaten me specifikat që janë kërkuar në dosje të tenderit. Mirëpo, të dy kompanitë kanë dorëzuar katalogje të krijuara vetë, i kanë listuar të gjitha specifikat teknike që janë kërkuar në mënyrë që pastaj kur të krahasohen ato të përputhen. Katalogjet dhe broshurat i krijon prodhuesi i pajisjeve, pasi vetëm prodhuesi i dinë specifikat e pajisjes që ka prodhuar. Pra, komuna nuk është dashur që të pranojë “katalogje” të tilla dhe është dashur të kërkohet katalogu origjinal i prodhuesit me produktet e së cilit kanë ofertuar Haxhijaha dhe Agrovin. Po të pranohen katalogje të krijuara nga ofertuesit atëherë ekziston rreziku që specifikat në katalog të përshtaten për kërkesat e dosjes së tenderit²¹. Arsyetimi i komunës është se në dosje është lejuar që të dorëzohen edhe foto me specifika teknike, mirëpo kompania fituese vetëm sa ka bërë përshkrimin e njëjtë të specifikave teknike të kërkuar në dosje të tenderit. Në dosje të tenderit është kërkuar që kapaciteti i rezervuarit të naftës të ketë 34 litra, të njëjtin kapacitet e ka shënuar në ofertë kompania Haxhijaha, mirëpo të dhënat nga faja e prodhuesit thotë që kapaciteti i modelit Tafe 42 DI ka 47 litra. Problemi qëndron se Haxhijaha nuk ka ofruar specifikat e prodhuesit, por i ka përshkruar specifikat e njëjta të cilat janë në dosje të tenderit. Problemi nuk është mospërputhja e tyre në këtë rast, pasi një kapacitet më i madh i rezervuarit është pozitiv, mirëpo është potenciali që komuna mund të mashtrohet nga ofertues të papërgjegjshëm të cilët i shkruajnë vetë katalogjet.

19 Tafe 42 DI EU 2WD

<https://tafetractors.com/tractors/TAFE-42-DI-EU.php>

20 Ligji nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2011.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

21 Drejt Komunave me Prokurim Publik të Hapur, Llogaridhënës dhe Efikas, faqe 9. Demokraci Plus. 2018.

<https://dplus.org/ep-content/uploads/2018/12/2018-12-03-Drejt-komunave-me-prokurim-te-hapur-llogaridhenes-dhe-efikas-ALB-Final-1.pdf>



Renovimi i QMF-së në Mamushë

Në aktivitetin e prokurimit për renovimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare morrën pjesë tre ofertues, ku fitues u zgjodh konsorciumi Intact SH.P.K. & NBT-ING me çmim 15,945.87 euro. Dy ofertuesit e tjerë u eliminuan për arsye se nuk kishin dorëzuar deklaratën për specifikimin teknik e cila ishte kërkuar në dosje të tenderit.

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	Intact SH.P.K. & NBT-ING	15,945.87
2.	Limit L&B	17,618.35
3.	Hysen Sopa B.I. & Construmax	30,033.75

TABELA 6. Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit "Renovimi i QMF-së në Mamushë"

Në dosje të tenderit janë kërkuar që ofertuesit të dorëzojnë së paku tri referenca për punë të ngjashme, por pa e specifikuar vlerën e përgjithshme të referencave. Kjo kërkesë është e gabuar pasi kërkesa do të duhej të ishte që ofertuesi të prezantojë referenca në një vlerë të caktuar, pra të mos kufizohet me numër të referencave, por vetëm vlera e tyre. Shumë opinione që lëshohen nga Agjencia Kundër Korrupsionit kanë të bëjnë me këtë lloj kërkesë të AK-së. Në Opinione shprehimisht thuhet se nuk duhet të kërkohet numri i kontratave, por mjafton që të dorëzohet një listë e kontratave e cila mbulon shumën e kërkuar nga AK²².

E gjetur tjetër është se janë kërkuar tri certifikata ISO, 9001, 14001 dhe OHSAS 18001, të cilat mund të mos jenë në përputhje me natyrën e projektit. ISO 14001 dhe OHSAS 18001 janë shumë të ngjashme mes vete, 14001 ka të bëjë me sistemin për menaxhimin e mjedisit, ndërsa OHSAS 18001 është standard që ka të bëjë me menaxhimin e sistemit të shëndetit dhe rrezikut në punë. Këto dy standarde ishin kërkuar edhe në tenderin për ndërtimin e sheshit, ku fitues si pjesë e konsorciumit ishte NBT-ING, fitues edhe në tenderin për renovimin e QMF-së. Vlera e parashikuar e tenderit është vetëm 20,000 euro dhe për tenderë të tillë nuk është praktikë të kërkohen tri certifikata. Në fakt në dy tenderë tjerë të Komunës së Mamushës që kanë të bëjnë me renovime, të iniciuar në vitin 2019, nuk është kërkuar asnjë certifikatë ISO.

22 Opinioni për Komunën e Gjilanit. Agjencia Kundër Korrupsionit. 2019.
https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Opinionet/2019/2366-19_opinion_dpkpp_K.Gjilanit.pdf



Komuna e Shtërpcës

Në të katër tenderët e monitoruar, komuna e ka pranuar vërtetimin nga gjykata për fituesin e kontratës e cila nuk i plotësonte të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Fituesi e ka sjellë vërtetimin me të cilin dëshmohet se kompania nuk ka qenë në falimentim apo insolvente, mirëpo jo edhe nëse ndonjë drejtor ose menaxher i saj i dënuar për vepër penale gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara.

Në tenderin për furnizim me dru dhe pelet, fituesi i zgjedhur fillimisht Orana & Acvilla nuk i ka dorëzuar certifikatat para nënshkrimit të kontratës. Komuna nuk e ka konfiskuar sigurinë e tenderit si dhe nuk ka bërë kërkesë në OSHP për të diskualifikuar konsorciumin Orana & Acvilla. Ekziston gjithmonë rreziku për marrëveshje të fshehta kur kompanitë që zgjedhen fituese tërhiqen ose nuk dorëzojnë dokumentet e kërkuara para nënshkrimit të kontratës. Në këtë rast dëmi i shkaktuar nga tërheqja e fituesit të parë është rreth 12,000 euro.

Në tenderin për transmetim të seancave dhe publikimeve të ndryshme është kufizuar konkurrenca pasi në dosje të tenderit është kërkuar që OE të ketë licencë për transmetim për Komunën e Shtërpcës.

Ndërsa në tenderin për sanimin dhe rregullimin e infrastrukturës ekzistuese, komuna i ka dhënë kontratën një kompanie e cila e ka pasur të dënuar drejtorin e saj, edhe pse sipas LPP-së nëse një kompani e ka të dënuar drejtorin ose menaxherin e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara për ndonjë vepër penale, nuk ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete të prokurimit. Kompania fituese nuk e mbulon kërkesën për kontrata të realizuara në vlerë prej 1.8 milion euro gjatë tri viteve të kaluara, ndërsa oferta e saj edhe në këtë pikë është e papërgjegjshme.



Mirëmbajtja e rrugëve lokale gjatë sezonit të dimrit në territorin e Komunës së Shtërpçës

Në tenderin për mirëmbajtje të rrugëve lokale gjatë sezonit të dimrit morën pjesë dy ofertues, kompania Euro Infrastruktura me çmim 22,400 euro, e cila u zgjodh fituese e tenderit dhe kompania Luboteni-A me çmim 25,523 euro, e cila dorëzoi tender të përgjegjshëm por me çmim më të lartë. Vlera e parashikuar e tenderit ishte 28,000 euro dhe afati për përfundimin e kontratës ishte shtatë muaj.

Kriteret e dosjes së tenderit, për dallim nga Komuna e Mamushës ishin shumë më të ulëta. Kërkesa për referenca është kërkuar si duhet, pra që OE të dorëzojë një listë të kontratave që e mbulojnë shumën e kërkuar, e cila në këtë rast është 20,000 euro.

Në kriteret e përshtatshmërisë, komuna ka kërkuar që OE fitues të dorëzojë vërtetimin nga Gjykata Themelore i cili dëshmon pranueshmërinë e OE sipas kërkesave në nenin 6.4 të dosjes së tenderit. Këto kërkesa bazohen në nenin 65 të LPP dhe ndahen në tri kategori të cilat gjenden në çdo dosje të tenderit. Në kërkesat e kategorisë së parë OE-ja duhet të dëshmojë se nuk ka ndihmuar në hartimin e dosjes së tenderit dhe se nuk ka konflikt interesi. Në kategorinë e dytë kërkohet që OE-ja të dëshmojë se ndonjë drejtor ose menaxher nuk është shpallur fajtor nga gjykata për disa lloje të veprave penale, ndërsa përmes kërkesave në kategorinë e tretë kërkohet të dëshmohet se kompania nuk është në falimentim ose insolvente. Euro Infrastruktura ka dorëzuar vërtetimin nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike se OE nuk shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy viteve të kaluara dhe ndaj të njëjtit nuk është iniciuar procedura e falimentimit. Certifikata është lëshuar në kuptim të nenit 65, paragrafi 4.1 dhe 4.2 të LPP-së. Mirëpo, kërkesa ka qenë që certifikata të lëshohet për të gjitha kërkesat që lindin nga neni 65. Shembull, kërkesa në paragrafin 3.1 të këtij neni thotë:

3. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara;

3.1. Është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në paragrafin 1. të nenit 130 të këtij ligji sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;

Vërtetimi të cilin e ka dorëzuar OE-ja nuk e dëshmon se ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk ka qenë i shpallur fajtor për kryerje të një vepre penale. Komuna nuk është dashur të pranojë këtë vërtetim dhe është dashur ta kërkojë përsëri vërtetimin nga OE-të më të cilin do të kishte dëshmuar pranueshmërinë sipas të gjitha pikave në nenin 65 të LPP-së. Praktikë e njëjtë është ndjekur edhe nga Komuna e Graçanicës dhe e Mamushës, të cilat kanë pranuar vërtetime të tilla.

Aktiviteti i prokurimit ka qenë i planifikuar dhe ky është veprim pozitiv. Nga tetë tenderët e analizuar më sipër, ky është i pari ku vlera e parashikuar në plan të prokurimit përputhet me vlerën e parashikuar të dosjes së tenderit.

Kontrata është nënshkruar më 4 tetor 2019, mirëpo është publikuar vetëm më 13 janar 2020, pra me një vonesë prej rreth tre muajshe. Në kontratë gjithashtu nuk është publikuar lista e çmimeve. Për t'u cilësuar një kontratë si e publikuar duhet të përmbajë kontratën, kushtet e përgjithshme të kontratës, kushtet e veçanta dhe listën e çmimeve. Kjo e fundit është pjesa më e rëndësishme pasi në të janë të dhëna çmimet e kompanisë që ka fituar kontratën për produktet/shërbimet e kërkuara nga autoritetet kontraktuese.



Furnizim dhe prerja e drunjve për ngrohje në shkolla dhe furnizim me pelet për ngrohje në ndërtesën e komunës

Në tenderin për furnizim me dru dhe pelet ofertuan katër kompani. Fillimisht e rekomanduar për kontratë ishte konsorciumi Orana & Acvilla me çmim prej 142,884 euro. Sipas raportit të vlerësimit të tenderit, ky konsorcium është rekomanduar që të shpallet fitues pasi kishte çmimin më të ulët, mirëpo ka dështuar të dërgojë certifikatat që kërkohen para nënshkrimit të kontratës (vërtetimi nga ATK-ja, vërtetimi nga Gjykata Themelore dhe vërtetimin për pagesë të tatimit në pronë). Komuna pas këtij veprimi, me kontratë e shpërbleu kompaninë Berveniku me çmim 155,373.90 euro, i cili është çmim më i lartë për rreth 12,000 euro më i lartë se oferta e Orana & Acvilla.

Sipas RrUOPP²³, nëse një ofertues është rekomanduar për fitues, mirëpo dështon t'i dorëzojë certifikatat e kërkuara, atëherë vazhdohet me ofertuesin e dytë, mirëpo AK-ja duhet që të konfiskojë sigurinë e tenderit si dhe të iniciojë procedurën për diskualifikimin e OE-së sipas nenit 99.2 të LPP-së. Komuna nuk e ka konfiskuar sigurinë e tenderit si dhe nuk ka bërë kërkesë në OSHP për të diskualifikuar konsorciumin Orana & Acvilla. Ekziston gjithmonë rreziku për marrëveshje të fshehta kur kompanitë që zgjidhen fituese tërhiqen ose nuk dorëzojnë dokumentet e kërkuara para nënshkrimit të kontratës. Në këtë rast dëmi i shkaktuar nga tërheqja e fituesit të parë është rreth 12,000 euro. Ky dëm do të mund të zvogëlohej nëse komuna do të konfiskonte sigurinë e tenderit që në këtë tender është 4,500 euro.

Çmimi i kontraktuar nga komuna është çmim i tregut pasi për një metër kub dru çmimi është 38.59 euro, ndërsa për një ton pelet 210 euro. Në këto çmime është përfshirë TVSH-ja dhe kur të merren parasysh çmimet në tregun me pakicë atëherë mund të thuhet se janë çmime të tregut. Kjo është mundësuar përmes vlerës së parashikuar të tenderit e cila është 155,400 euro. Çmimi i parashikuar për një metër kub dru është 38.59 euro dhe për një ton pelet 210 euro. Kur vlera e parashikuar është shumë më e lartë se çmimet e tregut atëherë ju mundëson kompanive të ofertojnë me çmime të larta, siç ka ndodhur në Komunën e Kamenicës²⁴.

Dosja e tenderit nuk ka kërkesa që do ta kufizonin konkurrencën, mirëpo komuna nuk ka kërkuar që OE-të të jenë të licencuara nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës. Kjo kërkesë është e zakonshme në çdo tender për furnizim me dru dhe përmes saj komuna sigurohet që drutë nuk janë të prera ilegalisht.

Komuna ka gabuar sa i përket kërkesës për validitet të tenderit. Ky tender është me vlerë të madhe, pasi vlera e parashikuar është mbi 125,000 euro dhe sipas RrUOPP validiteti i tenderit duhet të kërkohet për 90 ditë²⁵ ndërsa siguria e tenderit për 120 ditë. Komuna e ka kërkuar validitetin për 60 ditë, ndërsa sigurinë e tenderit për 90 ditë. Kjo nuk ka pasur ndonjë efekt të madh pasi fituesi është zgjedhur pa skaduar validiteti i ofertave, mirëpo kërkesa është dashur të jetë sipas RrUOPP. KV-të nuk janë kërkuar së bashku me dosjen e tenderit, mirëpo ato janë përfshirë në kontratë. Kriteret në KV duhet të jenë të cekura në dosje të tenderit e jo pasi të nënshkruhet kontrata, pasi ato vlejné për të gjithë ofertuesit e jo vetëm për fituesin e kontratës.

Përshkrimi i specifikimit të drurit është i mangët sepse mungojnë specifikat sa i përket llojit të drurit dhe niveli të lagështisë së tyre. Kërkesa e komunës është fare e thjeshtë, furnizimi me dru dhe prerja e tyre. Në treg ka dallim në çmimet e drurit (ahu apo bungu) dhe me këtë veprim është lejuar që kompania ta ketë në diskrecionin e saj se çfarë lloj druri do të dërgojë.

23 Neni 26.8, faqe 65. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. KRPP. 2019
https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01_2019/Rregullat_dhe_Udhezusi_10_04_2019_2.pdf

24 Problemet (e shumta) në Prokurim Publik, faqe 6-7. Demokraci Plus. 2020.
<https://dplus.org/wp-content/uploads/2020/03/2020-03-problemet-e-shumta-ne-prokurim-publik-1.pdf>

25 Neni 31.2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. KRPP. 2019
https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01_2019/Rregullat_dhe_Udhezusi_10_04_2019_2.pdf



Transmetimi integral i seancave të Kuvendit të Komunës së Shtërpcës dhe publikimet, njoftimet dhe konkurset e ndryshme në TV

Në tenderin për transmetim të seancave, publikimeve, njoftimeve dhe konkurseve të ndryshme ofertoj vetëm kompania Herc International, e cila fitoi tenderin me çmim 27,900 euro, apo për vetëm 100 euro më pak se vlera e parashikuar e tenderit, e cila ishte 28,000 euro.

Në kriteret e dosjes së tenderit është një kërkesë e cila ka mundur të kufizojë konkurrencën. Komuna ka kërkuar që OE-ja të ketë licencë nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM) për Komunën e Shtërpcës. Kjo do të thotë që vetëm TV kanalet që kanë licencë për transmetim në Komunën e Shtërpcës mund të ofertojnë. Me këtë është kufizuar konkurrenca gjë që bie ndesh me LPP-në, ndërsa kërkesa do të duhej të ishte që OE të ketë licencë nga KPM, por pa e përmendur territorin.

Në kontratë koha për të cilën është nënshkruar kontrata flet për periudhën prej 25.04.2019 deri më 24.10.2019, mirëpo kontrata është nënshkruar më 17.07.2019. Kjo mund të jetë ndonjë gabim teknik, mirëpo komuna duhet të sigurohet që datat në kontrata janë të sakta që mos të ketë pasoja në të ardhmen. Në kontratë gjithashtu nuk është përfshirë lista e çmimeve, e cila sipas RrUOPP është një nga elementet përbërës të kontratës dhe duhet të publikohet. Lista e çmimeve është elementi kryesor që iu intereson palëve të interesit pasi aty gjenden çmimet që ka ofruar për çdo artikull fituesi i kontratës.

Ky aktivitet i prokurimit është në planin e prokurimit për vitin 2019, mirëpo vlera e parashikuar në plan është 30,000 euro ndërsa në njoftim për kontratë, 28,000 euro.



Sanimi dhe rregullimi i infrastrukturës së ekzistuese në komunën e Shtërpcës

Në tenderin për sanimin dhe rregullimin e infrastrukturës ekzistuese ofertoj vetëm një kompani, Linda SH.P.K., e cila fitoi kontratën me çmim prej 1,098,199.95 euro, ndërsa vlera e parashikuar e tenderit ishte 1,621,847 euro. Linda SH.P.K. sipas raportimeve²⁶ e ka pasur të dënuar pronarin e saj dhe sipas nenit 65 të LPP ajo nuk ka të drejtë të ofertojë në tenderë. Neni 65, paragrafi 3 dhe 3.1 thotë:

3. *Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara;*

3.1. *Është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në paragrafin 1. të nenit 130 të këtij ligji sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;*

Pronari i Linda SH.P.K. ka qenë i dënuar në vitin 2013 dhe është liruar në vitin 2017. Paragrafi 3 i nenit 65 të LPP-së thotë se nëse ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor ka qenë i dënuar gjatë dhjetë viteve të fundit për veprë penale nuk ka të

26 Gazeta Insajderi. El Chapo Kosovar që arriti të përfitojë mbi 1 milion euro nga tenderët publik. 2017. <https://insajderi.com/hulumtime/el-chapo-kosovar-qe-arriti-te-perfitoje-mbi-1-milion-euro-nga-tenderet-publike/>

drejtë të marrë pjesë në aktivitete të prokurimit. Pasi tenderi për të cilin ka fituar Linda SH.P.K. është i vitit 2019, atëherë periodha prej 10 viteve të kaluara përfshin periudhën prej 2009 deri më 2019, ndërsa periodha kur është dënuar pronari i saj është brenda këtyre viteve.

Faktin se pronari i Linda SH.P.K. ka qenë i dënuar për vepër penale e ka vërtetuar edhe OSHP në vendimin 345/17²⁷.

Por si ka mundur që Linda SH.P.K. të fitojë kontratën? Ajo ka dorëzuar vetëm vërtetimin që nuk është shpallur e falimentuar ose insolvente gjatë dy viteve të kaluara dhe ndaj të njëjtës nuk është iniciuar procedura e falimentimit. Ndërsa kërkesa në dosje të tenderit që OE fitues të dorëzojë vërtetimin nga Gjykata Themelore i cili dëshmon pranueshmërinë e OE sipas kërkesave në nenin 6.4 të dosjes së tenderit. Këto kërkesa bazohen në nenin 65 të LPP-së dhe ndahen në tri kategori dhe të cilat gjenden në çdo dosje të tenderit. Në kërkesat e kategorisë së parë OE-ja duhet të dëshmojë se nuk ka ndihmuar në hartimin e dosjes së tenderit dhe se nuk ka konflikt interesi. Në kategorinë e dytë kërkohet që OE-ja të dëshmojë se ndonjë drejtor ose menaxher nuk është shpallur fajtor nga gjykata për disa lloje të veprave penale, ndërsa përmes kërkesave në kategorinë e tretë kërkohet të dëshmohet se kompania nuk është në falimentim ose insolvente. Komuna nuk është dashur të pranojë vërtetimin pasi nuk i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit.

Linda SH.P.K., ka ndërruar pronarin ndërkohë, ndërsa vërtetimi nga gjykata se një drejtues apo menaxher nuk ka qenë i dënuar me siguri do të lëshohet vetëm për drejtuesin aktual. Kjo gjë duhet të rregullohet nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, në mënyrë që kompanitë që kanë pronarë të dënuar të iu pamundësohet pjesëmarrja në aktivitete të prokurimit. Edhe pse LPP-ja thotë se kompanitë që janë dënuar nuk kanë të drejtë të ofertojnë, kjo sic duket nuk po respektohet, prandaj KRPP-ja duhet që këtyre kompanive të ua bllokojë qasjen në platformën e e-Prokurimit që ato të mos mund të ofertojnë deri sa të skadojë periodha e dënimit.

Linda SH.P.K. ka dorëzuar tender të papërgjegjshëm edhe për kërkesa të tjera të dosjes së tenderit. Për referenca në punë të ngjashme është kërkuar që vlera të jetë 1.8 milion euro. Linda SH.P.K. ka dorëzuar një listë me projekte të cilat kanë vlerën 5,344,387.05 euro, mirëpo dy kontrata nuk mund të llogariten pasi ato nuk kanë përfunduar, ndërsa kërkesa e dosjes së tenderit ishte që kontratat të jenë të përfunduara:

“Lista e projekteve të kryera në tre vitet e fundit, të paktën nga një për të gjitha llojet ose më shumë për ekzekutimin në fushën e punëve, ujësjellës, kanalizime, ndërtimi i rrugëve me kubza, asfaltimi i rrugëve dhe për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ose të ngjashme, në vlerë për të gjitha fushat prej 1,800,000.00 euro”.

Kontrata e lidhur me Komunën e Ferizajt për projektin “Bashkimi i qytetit – projekt dy vjeçar” është lidhur më 17.09.2018 me vlerë 4,030,290.80 euro ndërsa Linda SH.P.K. ka dorëzuar tenderin me 07.05.2019 dhe deri në atë moment projekti ka qenë ende i papërfunduar. Kontratë tjetër, shumica e së cilës nuk mund të llogaritet për të mbuluar vlerën e kërkuar është kontrata e lidhur me Komunën e Shtërpecës për projektin “Sanimi dhe rregullimi i infrastrukturës ekzistuese në territorin e komunës së Shtërpecës” me numër të prokurimit 655-16-068-5-1-1 e nënshkruar për një periudhë për 36 muaj me çmim 693,074.65 euro. Kjo kontratë është nënshkruar më 12.12.2016 dhe deri më 07.05.2019 kur është dorëzuar tenderi nuk ka mundur të jetë e përfunduar. Kur të hiqen këto dy vlera nga totali, atëherë vlera e kontratave të realizuara është 621,021.60 euro. Pasi kërkesa ishte për 1.8 milion euro, atëherë vlera e kontratave të realizuara nuk e mbulon kërkesën e dosjes së tenderit. Sipas RrUOPP-së, kur lista e kontratave të realizuara nuk e përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar atëherë tenderi duhet të refuzohet pa kërkuar informacione shtesë²⁸.

27 Vendimi 345/17. Organi Shqyrtues i Prokurimit. 2017.

http://arkivaoshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/345-17vendim_1.PDF

28 Neni 39.8. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. KRPP. 2019

[https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01 2019/Rregullat dhe Udhëzuesi 10 04 2019 2.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udhëzuesi%2010%2004%202019%202.pdf)

Dosja e tenderit nuk është pa gabime. Pikërisht në kërkesat për kontrata të realizuara, komuna ka kërkuar që OE të dorëzojë nga së paku një kontratë për punë në ujësjellës, kanalizim, ndërtim të rrugëve me kubza, asfaltim të rrugëve dhe rindërtim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës. Pra, të gjitha fushat OE-të që do të ofertonin do të ishin të obliguara të dorëzojnë nga së paku një referencë. D+ nuk ka hasur në një kërkesë të tillë kaq të gjerë ku kërkohen kontrata në pesë fusha në së paku 100 aktivitete të prokurimit të monitoruara që katër vite si dhe në rreth 2,000 vendime të OSHP-së. Kërkesa ka kufizuar konkurrencën dhe kjo mund të shpjegojë pse vetëm një kompani ka ofertuar për një tender me vlerë mbi një milion euro.

Gabim tjetër është se komuna e ka shkurtuar afatin për të dorëzuar ofertat. Arsyetimi i saj është “për arsyeje të vonesës së buxhetit, nevoja për ti përfunduar punët me kohë”. Ky arsyetim nuk qëndron dhe nuk është bindës pasi kontrata është për 36 muaj dhe punët mund të kryhen me kohë. Në anën tjetër vlerësimi i një oferte të vetme ka zgjatur për rreth 50 ditë, ndërsa do të duhej të përfundonte për 30 ditë²⁹. Me këtë vërtetohet që arsyeja për shkurtim të afatit për ofertim është e paqëndrueshme dhe është një nga veprimet me të cilin kufizohet konkurrenca.

Sigurimi i tenderit është kërkuar për 180 ditë, ndërsa do të duhej të kërkohej për 150 ditë, pasi validiteti i tenderit është kërkuar për 120 ditë dhe sipas RrUOPP-së, sigurimi i tenderit kërkohet për plus 30 ditë nga validiteti i tenderit³⁰.

Ashtu si në kontratat tjera të analizuara më lartë, nuk është përfshirë lista e çmimeve, e cila sipas RrUOPP-ja është një nga elementet përbërës të kontratës dhe duhet të publikohet. Lista e çmimeve është elementi kryesor që iu intereson palëve të interesit pasi aty gjenden çmimet që ka ofruar për çdo artikull fituesi i kontratës.

29 Neni 41.2. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. KRPP. 2019
[https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01 2019/Rregullat dhe Udhëzuesi 10 04 2019 2.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%2010%2004%202019%202.pdf)

30 Neni 29.6. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. KRPP. 2019
[https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01 2019/Rregullat dhe Udhëzuesi 10 04 2019 2.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%2010%2004%202019%202.pdf)



Komuna e Novobërdës

Në Komunën e Novobërdës janë analizuar katër tenderë, ndër to dy janë për punë, një për shërbim dhe një për furnizim.

Në tenderin për sanim të rrugëve dhe mirëmbajtje dimërore dhe verore të tyre komuna potencialisht ka kufizuar konkurrencën pasi në dosje të tenderit është kërkuar që OE-të t'i kenë përfunduar së paku dy projekte të ngjashme për tri vitet e fundit (2016, '17 dhe '18). Mirëpo, kërkesa do të duhej të ishte që OE-ja ta dorëzojë një listë të projekteve të realizuar për tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Në tenderin për ndërtim dhe mirëmbajtje të ndriçimit publik komuna ka shpërblyer me kontratë OE-në, e cila ishte e papërgjegjshme pasi që kishte dorëzuar librezë me afat të skaduar për automjetin i cili kërkohej në dosjen e tenderit. Gjithashtu OE-ja fituese kishte dhënë çmim jonormalisht të ulët për montimin e shtyllave të ndriçimit. Çmimi i tregut varion afër 80 euro për një shtyllë, ndërsa OE-ja ka dhënë çmimin prej 1.80 euro.

Në tenderin për furnizim me material ndërtimor është përdorur procedura me poentim, e cila mund shkaktojë pasiguri të OE-të. Ato nuk mund ta dinë paraprakisht sasi të që do të porositen, ndërsa rreziku është që një OE të ketë informata për sasi të që do të porositen dhe të japë çmime shumë të larta për ato që porositen më shumë dhe më të ulëta për ato që porositen më pak.

Në një aktivitet tjetër, për gëlqerosje të shkollave dhe ambulancave kërkesa për projekte të realizuara në tri vitet e fundit nuk është formuluar si duhet dhe në përputhje me interpretimin nga KRPP-ja.



Sanimi i rrugëve në Komunën e Novobërdës –Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore

Në tenderin për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve ofertuan gjashtë kompani. Vlera e parashikuar e tenderit ishte 60,000 euro, ndërsa u përdor procedura me poentim pasi AK nuk ka parashikuar sasinë e saktë të artikujve. Së pari fitues u zgjodh konsorciumi Ypsilon SH.P.K. & Luboteni-A me çmim të peshuar³¹ prej 36.06 euro. E pakënaqur me këtë vendim në OSHP u ankua kompania El Bau me pretendimin se fituesi si dhe tre ofertues tjerë kanë çmime jonormalisht të ulëta. OSHP aprovoi ankesën dhe vendosi se AK duhet që të vlerësojë ofertat në lidhje me pretendimin për çmime jonormalisht të ulëta³². Pas rivlerësimit fitues u zgjodh El Bau me çmim 350.07 euro. Vetëm El Bau dhe Avag Group & Eing Com me çmim 380,45 euro kanë çmim më të përafërt me çmimet e tregut, ndërsa katër ofertuesit tjerë kanë çmime nga tetë deri në dhjetë herë më të ulëta.

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	Ypsilon SH.P.K. & Luboteni-A	36.06
2.	Varna SH.P.K.	39.49
3.	Zuka Commerce	45.54
4.	L-Group & Rahovica Commerce	56.65
5.	El Bau	350.07
6.	Avag Group & Eing Com	380.45

TABELA 7.

Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit “Sanimi i rrugëve në Komunën e Novobërdës –Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore”

Në vlerësimin e parë komuna i shpalli të gjithë ofertuesit si të përgjegjshëm. Po të shikohet dallimi i madh në çmim atëherë mund të thuhet se komisioni i vlerësimit fare nuk i ka analizuar çmimet e ofertuesve për të parë nëse ka çmime jonormalisht të ulëta. Po ta bënte këtë atëherë me gjasë nuk do të kishte pasur ankesa në OSHP, e cila për një tender të tillë mund të shkaktojë probleme pasi mirëmbajtja varet prej sezonit.

Në dosje të tenderit është kërkuar që OE-të t'i kenë përfunduar së paku dy projekte të ngjashme për tri vitet e fundit (2016, 17 dhe 18). Kërkesa do të duhej të ishte që OE-ja ta dorëzojë një listë të projekteve të realizuara për tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Kërkesa duhet të formulohet si e tillë pasi AK-ja nuk mund të kufizojë listën e projekteve me numër, por duhet të kërkohet vlera e projekteve të përfunduara, që në këtë rast AK nuk ka caktuar vlerë. Kërkesa e komunës potencialisht ka mundur ta kufizojë konkurrencën, pasi një OE që ka vetëm një referencë por ndoshta me vlerë shumë të madhe nuk do të mund të merrte pjesë në tender, mirëpo një tjetër që i ka dy projekte të realizuara me vlerë relativisht shumë më të vogël do të mund të ofertonte.

31 Çmimi i peshuar nënkupton që artikujt grupohen në kategori të caktuara dhe secilës prej tyre i jepet një peshë e caktuar, që në total është 100%. Shembull, nëse një ofertues ka dhënë çmimin 100 euro për një grumbull të artikujve, i cili e ka peshën 30%, atëherë çmimi i peshuar do të ishte 30 euro (100 * 0.3). Çmimi i peshuar shërben vetëm për të zgjedhur fituesin, mirëpo kontrata lidhet me çmimet për artikuj që ka dhënë kompania.

32 Vendimi 483/19. Organi Shqyrtues i Prokurimit. 2019.
<http://arkivaoshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/483-19vend.pdf>

Deri më 24.12.2019 është dorëzuar një faturë në vlerë 51,000 euro. Komuna ka bërë porosi vetëm për tri pozicione të paramasës, e cila ka edhe 25 pozicione tjera duke harxhuar 85% të buxhetit ndërsa kontrata përfundon në tetor të vitit 2020. Pasi komuna ka përdorur procedurën me poentim, atëherë nuk mund të shtojë buxhet pasi nuk vlen pragu prej plus minus 30% për këtë lloj të kontratave. Komuna do ta ketë problem përfundimin me sukses të kontratës pasi i kanë mbetur vetëm 9,000 euro, ndërsa shumë pozicione me siguri që nuk do të porositen fare.

Aktiviteti i prokurimit ka qenë i planifikuar dhe është me vlerë të njëjtë sikurse në njoftimin për kontratë, pra 60,000 euro.

Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në Komunën e Novobërdës 2019-2020

Komuna e Novobërdës ka përdorur procedurën me poentim edhe për tenderin për ndërtim dhe mirëmbajtje të ndriçimit publik, në të cilin ofertuan shtatë kompani. Fitues u zgjodh Monti SH.P.K. me çmim të poentuar prej 149.78 i cili ishte gjithashtu çmimi më i lirë. Dy ofertues të tjerë u eliminuan për shkak të gabimit aritmetikor për më tepër se 2% të ofertës, ndërsa katër ofertues ishin të përgjegjshëm, por me çmim më të lartë se fituesi.

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	Monting SH.P.K.	149.78
2.	Niti-N SH.P.K.	156.39
3.	Light and More SH.P.K.	160.00
4.	M.V.R. Elektromontues	182.90
5.	ETM Group SH.P.K.	201.63
6.	N.N.P. Toni	343.21
7.	Risa Mont	536.02

TABELA 8. Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në Komunën e Novobërdës 2019-2020”

Oferta e Monting SH.P.K. i ka disa të meta për të cilat oferta e saj mund të cilësohej si e papërgjegjshme. Në dosjen e tenderit është kërkuar që ofertuesi të ketë një kamion me korpë (kamion për ngritje në lartësi të punëtorëve), i cili është dashur të dëshmohet me librezë që kanë afat të regjistrimit. Monting SH.P.K. ka dorëzuar një librezë të cilës i ka skaduar afati i regjistrimit më 08.06.2019, ndërsa oferta është dorëzuar më 14.06.2019.

Në paramasë në pozicionin 4 është kërkuar blerja, transporti dhe montimi i shtyllave ndriçuese të zinkuara me lartësi 7m. Për këtë pozicion Monting ka dhënë çmim 1.80 euro, i cili është abuzues dhe jonormalisht i ulët pasi çmimi në treg i shtyllave ndriçuese është rreth 80 euro. Çmim edhe më i lartë, saktësisht 96.97 euro, gjendet në listën me

çmime referente të publikuar nga KRPP në vitin 2015³³. Kjo nënkuptohet se komisioni i vlerësimit nuk i shikon fare çmimet e ofertuesve, por vetëm i gjykon a janë të përgjegjshëm në bazë të kërkesave administrative. Mirëpo, çmimi është elementi kryesor i një oferte dhe ato duhet të analizohen një nga një se a janë çmime të tregut. Mund të tolerohen devijime të vogla sa i përket mesatares së tregut, mirëpo në këtë rast çmimi që ka ofruar Monting SH.P.K. është për 98% më i ulët se çmimi i tregut.

Tri fatuara të paguara nga komuna kapin shumën 50,000 euro, përderisa vlera e parashikuar e tenderit ishte 60,000 euro. Në këto tri fatura nuk është porositur asnjëherë pozicioni 4 ku Monting SH.P.K. kishte dhënë çmim 1.80 euro, mirëpo është porositur pozicioni 3 që ka të bëjë me furnizim me shtylla të betonit për të cilat çmimi i dhënë është 88.50 euro. Dyshimi është që OE e ka ditur se çfarë lloj shtyllash do të porosisë komuna, prandaj ka dhënë çmim 1.80 euro për shtyllat e zinkuara dhe 88.50 për shtyllat e betonit. Asnjë OE nuk ofron çmim tepër të ulët me një pozicion nëse nuk mund ta mbulojë çmimin me pozicione tjera. Kësaj i ka ndihmuar edhe përdorimi i procedurës me çmim të poentuar pasi i mundëson komunës që mos të jap sasinë e saktë të artikujve dhe në këtë rast komuna mund të porosisë një artikull e një tjetër të mos e porosisë fare. Po të ishte dhënë sasia, komuna do të mund të përdorte devijimin prej plus minus 30% për pozicion por së paku 70% të sasive për çdo artikull do të duhej ta porosisë.

Në dosje të tenderit është kërkuar që ofertuesit t'i kenë të përfunduar së paku tri projekte në tri vitet e fundit (2016, 17, 18) në ndërtim apo mirëmbajtje të ndriçimit publik, por pa e specifikuar vlerën e përgjithshme të referencave. Komuna ka bërë tri gabime me këtë kërkesë. Së pari, kërkesa është dashur që të jetë për tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Me këtë do të përfshihej periudha nga maji i vitit 2016 deri në majin e vitit 2019. Së dyti, kërkesa për tri referenca e kufizon konkurrencën, ndërsa do të duhej të kërkohej që ofertuesi të prezantojë referenca në një vlerë të caktuar, pra të mos kufizohet me numër të referencave, por vetëm në vlera e tyre. Shumë opinione të Agjencisë Kundër Korrupsionit kanë të bëjnë me këtë lloj kërkesetë AK. Në opinione shprehimisht thuhet se nuk duhet të kërkohej numri i kontratave, por mjafton që të dorëzohet një listë e kontratave e cila mbulon shumën e kërkuar nga AK³⁴. Së treti komuna është dashur të kërkojë një listë të projekteve për fusha të ngjashme e jo të kufizohet në ndërtim dhe mirëmbajtje të ndriçimit publik. Këto tri gabime janë lehtë të evitueshme në qoftë se komuna e riformulon kërkesën duke u bazuar në LPP dhe RrRUOPP.



Furnizim me material ndërtimor

Në tenderin për furnizim me material ndërtimor oferto vetëm një kompani NTP Osmani e cila fitoi kontratën më çmim të poentuar prej 659.73 euro, ndërsa vlera e parashikuar e tenderit ishte 40,820 euro. Ky është aktiviteti i tretë që D+ ka monitoruar në të cilën është përdorur procedura me poentim të çmimit. Kjo procedurë përdoret kur AK për arsye të ndryshme nuk e dinë sasinë e artikujve që do të porosisë, mirëpo AK duhet të mundohet që të përcaktojë sasinë e përafërt. Përdorimi i procedurës me poentim shkakton pasiguri të OE-të pasi ato nuk mund t'i dinë paraprakisht sasinë që do të porositen. Ekziston rreziku që një OE të ketë informata për sasinë që do të porositen dhe të japë çmime shumë të larta në ato që porositen më shumë dhe më të ulëta në ato që porositen më pak. Kjo ka ndodhur në tenderin për ndërtim dhe mirëmbajtje të ndriçimit publik, për të cilën është shkruar më lartë.

Në dosje të tenderit janë kërkuar dy kamionë, minimum 6 ton, ndërsa librezat të kenë afat të regjistrimit. NTP Osmani ka dorëzuar dy librezat në ofertë, mirëpo ka dorëzuar vetëm faqen e parë e librezës në të cilën nuk tregohet se a kanë afat të regjistrimit. Ky është një lëshim nga komisioni i vlerësimit sepse është dashur që të kërkohej të dorëzohen edhe faqet tjera ku do të mund të shihej se a kanë afat të regjistrimit kamionët. Mjetet e zotuarja janë 26,040 euro, ndërsa vlera e parashikuar ishte 40,820 euro dhe pasi fituesi është zgjedhur me poentim, komuna nuk do të mund të shpenzojë më shumë se mjetet që ka zotuar.

33 PN1347. Lista e çmimeve njësi mesatar referent për punë ndërtimore dhe materiale ndërtimore. KRPP. 2015 <https://bit.ly/2LDWJEE>

34 Opinion për Komunën e Gjilanit. Agjencia Kundër Korrupsionit. 2019.

https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Opinionet/2019/2366-19_opinion_dpkpp_K.Gjilanit.pdf



Gëlqerosja e shkollave dhe ambulancave në Komunën e Novobërdës

Tenderi për gëlqerosje të shkollave dhe ambulancave ka vlerën e parashikuar më të ulët nga të gjithë tenderët e analizuar me një vlerë prej 9,950 euro. Ofertuan tetë OE, ndërsa fitues u zgjodh kompania L-Group me çmim 7,764 euro, e cila njëkohësisht ishte me çmimin më të lirë. Një kompani ishte eliminuar për shkak se nuk ka plotësuar si duhet formularin e tenderit, ndërsa gjashtë të tjera ishin të përgjegjshme, por me çmim më të lartë.

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera e ofertës në euro
1.	L-Group	7,764.38
2.	4ING	8,016.39
3.	Izmornik D.O.O.	8,192.01
4.	Lurn SH.P.K. & Rexha SH.P.K.	8,884.10
5.	NNP Ndërtimtari	9,308.00
6.	Osmani Holding & NNP Lavdimi	9,758.10
7.	Global Ing	9,925.86
8.	Ceni Group	10,899.50

TABELA 9.

Ofertat e kompanive për aktivitetin e prokurimit "Gëlqerosja e Shkollave dhe Ambulancave në Komunën e Novobërdës"

Për shkak të vlerës së ulët të tenderit, komuna nuk ka pasur shumë kritere në dosje të tenderit. Mirëpo, njëri nga kriteret që nuk është kërkuar si duhet është ai që OE të dorëzojnë së paku një projekt të ngjashëm të realizuar brenda tri viteve të fundit (2015, '16, '17). Kërkesa do të duhej të ishte që projektet të jenë të realizuara për tri vitet e kaluara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë që ka qenë më 05.11.2018. Sipas interpretimit nga KRPP-ja³⁵ periudha tre vjeçare duhet të përfshijë vitin vijues, do të thotë vitin në të cilin është publikuar njoftimi për kontratë dhe në rastin e këtij e tenderi periudha 2015 – 2018. Megjithatë edhe po të ishte kërkesa e tillë, OE-ja fituese e kontratës ka dorëzuar referenca që e mbulojnë këtë periudhë.

35 Pyetjet e Shpeshta, nr. 57. KRPP. 2017.
<https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNeë.aspx?id=268>

Rekomandime

Për të gjitha komunat:

- Komunat të kërkojnë nga fituesi i kontratës vërtetimin nga Gjykata Themelore që një drejtor ose menaxher i saj nuk është dënua gjatë dhjetë viteve të fundit për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 65 paragrafi 3 dhe 3.1 të LPP-së;
- Një nga kërkesat kryesore të dosjes së tenderit është që OE të dëshmojë që ka kontrata të realizuara në tri vitet e fundit. Kërkesa duhet të jetë që OE të dorëzojë një listë të projekteve të realizuara të cilat mbulojnë një shumë të caktuar të kërkuar nga AK. Nuk duhet që të kufizohet konkurrenca me kërkesë për numër të caktuar të projekteve të realizuara.



Për Komunën e Graçanicës:

- Të sigurohet që të përdoret procedura e duhur për aktivitetet e prokurimit;
- Siguria e ekzekutimit të kërkohet në përputhje me ligjin, pra një vlerë prej 10% të çmimit të kontratës për një periudhë +30 ditë nga data e planifikuar e përfundimit të kontratës;
- Siguria e tenderit të llogaritet 1 deri 3% të vlerës së parashikuar ose minimumi 1,000 euro;
- Kushtet e Veçanta të përcaktohen së bashku me dosje të tenderit në mënyrë që ofertuesit t'i dinë të gjitha kushtet dhe të përgatisin ofertat e tyre duke u bazuar në këto kushte;
- Të publikohen të gjitha kontratat në E-Prokurim, përfshirë listën e çmimeve në një kohë të arsyeshme posa të nënshkruhet kontrata;
- Aktivitetet të planifikohen dhe të publikohen në planin e prokurimit.



Për Komunën e Mamushës:

- T'i bëhet një vlerësim punës së komisioneve të vlerësimit të ofertave pasi ka shumë gabime duke përfshirë dhënie të kontratës për konsorciumin i cili nuk kishte dorëzuar deklaratën për themelimin e konsorciumit;
- Të evitohen kërkesa për certifikata ISO të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë me natyrën e projektit;
- Për OE që nuk dorëzojnë dokumentet e kërkuara para nënshkrimit të kontratës të iniciohet procedura për diskualifikimin e tyre në përputhje me nenin 26.8 të RrUOPP-së;
- Kur të kërkohen katalogje dhe broshura si kriter, ato duhet të pranohen vetëm nga prodhuesi e jo ato që shkruhen nga vetë ofertuesi.



Për Komunën e Shtërpcës:

- Të sigurohet që nuk do të shpërblejë me kontratë OE-të të cilët kanë pasur pronarët e dënuar në të kaluarën;
- Për OE-të që nuk dorëzojnë dokumentet e kërkuar para nënshkrimit të kontratës të iniciohet procedura për diskualifikimin e tyre në përputhje me nenin 26.8 të RrUOPP-së;
- Nga lista e projekteve të dorëzuara nga OE-të duhet të llogariten vetëm projektet që kanë përfunduar dhe jo ato në realizim e sipër;
- Të mos kufizohet konkurrenca me kërkesa të cilat mund të ju përshtaten vetëm një ose disa OE-ve



Për Komunën e Novobërdës:

- T'i bëhet një vlerësim punës së komisioneve të vlerësimit të ofertave pasi ekziston dyshimi se çmimet e ofertave nuk analizohen fare dhe në dy aktivitete të prokurimit ka çmime jonormalisht të ulëta;
- Ofertat të vlerësohen sipas kriterëve të vendosura në dosje të tenderit;
- Procedura me poentim të çmimeve të përdoret vetëm atëherë kur komuna nuk e din sasinë e artikujve që do të porositen;
- Kërkesa për projekte të realizuar në tri vitet e fundit të formulohet në atë mënyrë që të përfshijë tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.



Norwegian Embassy

